



BASHKIA  
TIRANË

**R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë**  
**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE**

[Dt. 28.01.2022]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**OPERATORIT EKONOMIK “3i-Solutions” sh.p.k**

**Adresa:** Tirane Rruga "Stavro Vinjau", Pallati 2. H. 9, Zona Kadastrale Nr. 8160

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Platforma e-Rekrutim” me Nr. reference REF-14970-12-13-2021** për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini Nr.185 datë 20 Dhjetor 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1 Operatori ekonomik “INFOSOFT SYSTEMS” SHPK**

**NUIS J61820021C**

Vlera e ofertës pa tvsh = **10.830.000** (dhjetë milion e tetëqind e tridhjetë mijë) lekë.

**2 Operatori ekonomik “3i-Solutions” sh.p.k**

**NUIS: L52305007S**

Vlera e ofertës pa TVSH– 10.565.000 (dhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1 Operatori ekonomik ”INFOSOFT SYSTEMS” SHPK**

**NUIS J61820021C**

Për arsyet e mëposhtme:

I. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të dokumenteve standarde të tenderit, përcakton se ofertuesi duhet të paraqesë:

*“2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:*

*Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9”.*

Në nenin 26 të VKM, përcaktohet:

*“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla...”*

Operatori ekonomik “Infosoft Systems” Sh.p.k nuk ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 9, por për të vërtetuar përmbushjen e kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion për përmbushjen e pikës:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së; (vetëm vërtetim për pagesën e detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe jo për shlyerjen e taksave)

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ndërkohë, në vijim të arsyetimit më sipër, KVO gjendet përpara faktit se, duke qënë se nuk është paraqitur formulari i vetëdeklarimit sipas shtojcës 9, nuk mund të gjykojë dhe të vlerësojë për përmbushjen e kritereve të tjera të përgjithshme të kualifikimit si më poshtë vijon:

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qënë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së (mungon vërtetimi për shlyerjen e taksave);

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qënë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

**Sa më sipër, Operatori ekonomik “Infosoft Systems” Sh.p.k nuk ka përmbushur kriterin “2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë” pjesë e kritereve të veçanta të kualifikimit, të DST.**

II. Pjesë e kritereve të veçanta të kualifikimit, është kërkesa sipas pikës “2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

*“2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë*

30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9”.

**Operatori ekonomik “Infosoft Systems” Sh.p.k nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përmbushjen e kriterit 2.2.3.**

III. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.të kapacitetit teknik, pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit, ka kërkuar:

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara....

Operatori ekonomik ka paraqitur në spe, kontratë të lidhur me ent publik (Ministrinë e Shëndetësisë) me datë 12.11.2015 dhe vlerë kontrate 646.950.690 lekë pa tvsh, vërtetim për realizim kontrate të datës 23.10.2019, në të cilin cilësohet realizimi me sukses i kontratës pa përfshirë SLA, në vlerën 441.960.000. Gjithashtu, OE ka paraqitur faturat tatimore të shitjes, të cilat deri në datën 28.12.2017, përputhen me vlerën e realizimit të përcaktuar në vërtetim (441.960.000) lekë (pa përfshirë SLA).

Referuar sa më sipër dhe referuar pikës 2.3.1 (a) të kriterit të sipërcituar, vërtetimi i realizimit (pa përfshirë SLA dhe referuar faturave tatimore të shitjes), i referohet periudhës deri në datën 28.12.2017, dhe nuk përputhet me kërkesën e AK për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit.

**Në këto kushte, kriteri 2.3.1 i Kapacitetit teknik, nuk përmbushet nga OE.**

Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik, pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit, ka kërkuar:

**2.3.3** Për të garantuar implementimin me sukses të projektit, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

a. 1 (një) menaxher projekti me minimumi 3 (tre) vite eksperiencë për menaxhimin në kohë dhe me cilësi të projektit (Çertifikimi duhet të jetë aktiv, i kategorizuar në nivelin minimal profesional, në fushën e menaxhimit agile ose ekuivalente).

- b. 1 (një) punonjës, i certifikuar për ITIL Foundation ose ekuivalente.
  - c. 1 (një) zhvillues me të paktën 2 (dy) vjet eksperiencë, të certifikuar në nivelin MCSA - *Ëeb Applications* ose ekuivalente.
  - d. 2 (dy) zhvillues (frontend) me të paktën 2 (dy) vjet eksperiencë, të certifikuar në programim (HTML5/CSS3/JS) ose ekuivalente.
  - e. 2 (dy) zhvillues (backend) me të paktën 2 (dy) vjet eksperiencë, të certifikuar në gjuhën e programimit C# në .NET ose java ose ekuivalente.
  - f. 1 (një) punonjës të certifikuar për Testues softëare.
  - g. 1 (një) trajnues me të paktën 1 (një) vit eksperiencë dhe certifikimin përkatës
  - h. 1 (një) punonjës të certifikuar si Analist Biznesi Softëare në proceset Agile ose ekuivalent.
- Gjithsesi në vijim të arsyetimit, vlen të përmendet fakti se AK ka specifikuar se një punonjës mund të ketë një ose disa certifikata për përmbushjen e këtij kriteri.

Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Certifikatat përkatëse për secilin nga specialistët e mësipërm dhe CV sipas pikave (a, c, d, e, g) për të vërtetuar eksperiencën në punë.
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B;
- Listëpagesat sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.

Operatori ekonomik “Infosoft Systems” Sh.p.k, për pikën (c) të këtij kriteri “1 (një) zhvillues me të paktën 2 (dy) vjet eksperiencë, të certifikuar në nivelin MCSA - *Web Applications* ose ekuivalente”, nuk ka paraqitur dokument ne spe për përmbushjen e kriterit 2.3.3 (c).

Operatori ekonomik “Infosoft Systems” Sh.p.k, për pikën (d) të këtij kriteri “2 (dy) zhvillues (frontend) me të paktën 2 (dy) vjet eksperiencë, të certifikuar në programim (HTML5/CSS3/JS) ose ekuivalente”, nuk ka paraqitur dokument ne spe për përmbushjen e kriterit 2.3.3 (d).

Operatori ekonomik “Infosoft Systems” Sh.p.k, për pikën (f) të këtij kriteri “1 (një) punonjës të certifikuar për Testues softëare”, nuk ka paraqitur dokument ne spe për përmbushjen e kriterit 2.3.3 (f).

**Sa më sipër, KVO konstaton se operatori ekonomik “Infosoft Systems” Sh.p.k, nuk ka përmbushur kriterin 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”, kriterin 2.2.3. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit, kriterin 2.3.3. (c), (d) (f) të kapacitetit teknik, si pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e**

**shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“3i-Solutions” sh.p.k.**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 10.565.000 (dhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferta e Suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.